



BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.3 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

Nr.Prot. _____ Tiranë ____/____/ 2016

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Datë **02/09/2016**

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Tirane

Për: Operatorin ekonomik, **“ALCANI” Sh.p.k me NIPT J91505006Q.**

Adresa: Rruga “Frutikulturës”, Kamëz, Tirane

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozime

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Procedurë “Kërkesë për Propozime” me objekt **“Blerje Dru Zjarri dhe shperndarje ne objektet shkollore dhe parashkollore”**, kohëzgjatja e kontratës deri 31.12.2016 nga nënshkrimi i kontratës.

Fondi limit: 6,013,333 (*gjashtë milion e trembëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e tre*) Lekë pa t.v.sh

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 15.08.2016

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara si më poshtë;

1. Operatori ekonomik **“ALCANI” Sh.p.k me NIPT J91505006Q**, me adrese Rruga “Frutikulturës”, Kamëz, Tirane, me ofertë **6,013,060** (*gjashtë milion e trembëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë*) Lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik **“Gjergj Buça” Sh.p.k me NIPT K31331547R**, me adrese Rruga “Autostrada Tiranë -Durrës”, Ura e Dajlanit, Lagja 14, Durrës, me ofertë **5,822,000** (*pesë milion e tetëqind e njëzet e dy mijë*) Lekë pa TVSH.

Skualifikohet:

1. Operatori ekonomik **“Gjergj Buça” Sh.p.k me NIPT K31331547R** për shkak se nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit(DST) të cilat janë si më poshtë;
 - a) Vërtetimi i OSHEE nuk është lëshuar në datën e përcaktuar në DST sipas kërkesave ligjore. Duhet të konfirmonte shlyerjen e detyrimeve të maturuara që do të thotë duhet të lëshohet pesë ditë para depozitimit të ofertës.
 - b) Leja mjedisore e tipit C është për Nikolin Gjaci dhe jo për operatorin ekonomik Gjergj Buça.
 - c) Operatori ekonomik nuk e përcakton në cilin vend ndodhet magazina ku është i depozituar malli objekt prokurimi. Në DST-ë kërkohet që të përcaktohet vendodhja e magazinës të jetë brenda qarkut Tiranë.
 - d) Operatori ekonomik duhet të dorëzojë vërtetimin e realizimit të kontratës për kontrata të lidhura me autoritete kontraktore. Operatori ekonomik ka paraqitur kontratën dhe faturat tatimore por nuk ka paraqitur vërtetimin e realizimit të kontratës lëshuar nga Autoriteti Kontraktor.
 - e) Listëpagesat për punonjësit të paraqitura nuk janë të konfirmuara nga organet tatimore sipas kërkesave të DST. Gjithashtu dhe për punonjësit e siguruar nuk ka paraqitur vërtetim nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore sipas kërkesave të DST.
 - f) Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton dëshmitë për mjetet e pajisjet teknike të cilat shërbejnë për çarje dhe prerje të druve të zjarrit, përveç disa fotove të mjeteve e pajisjeve.
 - g) Nga gjendja e magazinës e paraqitur nga operatori ekonomik, rezulton se në magazinë ndodhen 755 mst dru zjarri, ndërkohë në DST-ë është kërkuar më shumë.
 - h) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e punonjësve për përdorimin e makinerive dhe mjeteve prerëse të lëshuara nga organet kompetente, operatori ekonomik Gjergj Buça nuk i ka paraqitur.
 - i) Kontrata me D.SH.P është kontratë e lidhur mes Nikolin Gjacit dhe D.SH.P. dhe jo operatorit ekonomik Gjergj Buçaj.
 - j) Gjithashtu kontrata me D.SH.P është kontratë e lidhur mes Nikolin Gjacit dhe D.SH.P.
 - k) Kontrata e bashkëpunimit mes Gjergj Buça-jt dhe Nikolin Gjaci nuk është i formuluar në përputhje me kërkesat ligjore të cilat përcaktojnë dhe mënyrën e realizimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, Operatorin ekonomik;**“ALCANI” Sh.p.k me NIPT J91505006Q**, me seli ne Adresa:Rruga “Frutikulturës”, Kamëz, Tirane, se oferta me vlerë**6,013,060 (gjashtë milion e trembëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH**,e paraqitur përtenderin me objekt**“Blerje dru zjarri dhe shperndarje ne objektet shkollore dhe parashkollore”**, me afat të kryerjes së shërbimeve deri 31.12.2016 nga nënshkrimi i kontratës, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit, Tiranë, Rruga 5 maji, pranë Tregut të Medresesë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe procedura e prokurimit do të anulohet, sipas të ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 “Për prokurimet publike”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25/08/2016

Ankesa: S`ka pasur

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Artion ÇAUSHLLARI

